



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr. 09 dt. 22.05.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR
VITIN 2025**

Këshilli i Qarkut Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për “Miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025”, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, 18 dhe 26 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kreun II, III, të VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të ndryshuar, VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut Korçë, nr. 50, datë 23.12.2024, “Mbi miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës, të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2025”, me propozim të kryesisë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë të vitit 2025, (Plani vjetor u hartua me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë mbështetur në bazën ligjore të përmendur më sipër, bashkëngjitur)
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI

Erjon Nexhipi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. 394 Prot.

Korçë, më 16.05.2025

**PLANI VJETOR I PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KËSHILLIN E QARKUT KORÇË PËR VITIN 2025**

Në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë nr. 48, datë 14.05.2025 për hartimin dhe miratimin e Planit të pranim/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025, Njësia e Burimeve Njerëzore bazuar në nenin 83 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 dhe 26 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreun II, III, të VKM nr. nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të ndryshuar, VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në Kategorinë ekzekutive” (ndryshuar me vkm nr. 746, datë 19.12.2018), dhe VKM nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, hartoi planin vjetor të pranim/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025:

Numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurimi të jetë 4 (katër), shpjeguar si më poshtë:

1. 1(një) vend vakant për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (drejtor drejtorie në DAMT; Funksion i deleguar pranë Këshillit të Qarkut Korçë).
 - Klasa e pagës III-1 dhe grup diplome 1, përcaktuar në lidhjen nr. 1 të VKM nr. 421, datë 26.06.2024.
 - Plotësimi i vendit të lirë do të bëhet me procedurë për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë. Procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë.
2. Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
 - Kategori e ulët drejtuese. Klasa e pagës III-2 dhe grup diplome 1, përcaktuar në lidhjen nr. 7 të VKM nr. 503, datë 01.08.2024.
 - Plotësimi i vendit të lirë do të bëhet me procedurë për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë. Procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë.
3. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit.
 - Kategori e ulët drejtuese. Klasa e pagës III-2 dhe grup diplome 1, përcaktuar në lidhjen nr. 7 të VKM nr. 503, datë 01.08.2024.

- Plotësimi i vendit të lirë do të bëhet me procedurë për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë. Procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë
4. Specialist për Financën dhe Buxhetin.
- Kategoria Ekzekutive. Klasa e pagës IV-2 dhe grup diplome 1, ose 2, ose 3, përcaktuar në lidhjen nr. 7 të VKM nr. 503, datë 01.08.2024.
 - Plotësimi i vendit të lirë do të bëhet me procedurën e lëvizjes dhe pranimi në shërbimin civil. Procedurat për lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil aplikohen në të njëjtën kohë.

Vendi vakant për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (*drejtor drejtorie në DAMT; Funksion i deleguar pranë Këshillit të Qarkut Korçë*), vazhdon të jetë i lirë. Është bërë procedura disa herë, por në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të publikuara në shpalljen për konkurrim, për pozicionin e mësipërm nuk ka patur kandidatura të përzgjedhura.

Tre vendet e tjera të lira, janë krijuar nga ristrukturimi i Institucionit në bazë të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025" përkatësisht:

- Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
- Përgjegjës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit.
- Specialist për Financën dhe Buxhetin.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Redin Latollari

KRYETARI

Erjon Nexhipi

